

KËRKESË PËR INFORMACION

Numër protokolli 2412/0172

Emër Mbiemër ¹ :		Data: 17/12 /2024
-----------------------------	--	-------------------

Autoriteti Publik: Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri
Qyteti: Tiranë

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Në bazë të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, kërkojmë si informacion:

1. Listën e plotë të subjekteve që janë miratuar nga AKEP-i në vitin 2018 për të operuar në rrjetin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST).
2. Listën e plotë të subjekteve që janë miratuar nga AKEP-i në vitin 2019 për të operuar në rrjetin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST).
3. Listën e plotë të subjekteve që janë miratuar nga AKEP-i në vitin 2020 për të operuar në rrjetin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST).
4. Listën e plotë të subjekteve që janë miratuar nga AKEP-i në vitin 2021 për të operuar në rrjetin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST).
5. Listën e plotë të subjekteve që janë miratuar nga AKEP-i në vitin 2022 për të operuar në rrjetin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST).
6. Listën e plotë të subjekteve që janë miratuar nga AKEP-i në vitin 2023 për të operuar në rrjetin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST).
7. Listën e plotë të subjekteve që janë miratuar nga AKEP-i nga 1 janari 2024 – 15 dhjetor 2024 për të operuar në rrjetin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

Bazuar në nenin 13 të Ligjit 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe nenit 5 të Rregullores nr. 47, datë 26.10.2017 “Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm”, cildo sipërmarrës është i lirë të ofrojë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë. Ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë bëhet kundrejt autorizimit nga AKEP. Autorizimi i jep të drejtë sipërmarrësit të negociojë për interkoneksion dhe, kur është e zbatueshme, për të marrë akses nga sipërmarrësit e tjerë të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve të disponueshme për publikun, në përputhje me këtë ligj.

Bazuar në nenin 14 të Ligjit 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe nenit 6 të Rregullores nr. 47, datë 26.10.2017 “Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm”, cildo sipërmarrës që, për qëllime fitimi, parashikon të ofrojë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike, duhet të njoftojë AKEP-in përpara fillimit të funksionimit, ndryshimit ose ndërprerjes.

Pas kryerjes së njoftimit nga sipërmarrësi, AKEP konfirmon kryerjen e regjistrimit të sipërmarrësit në “Regjistri i sipërmarrësve që kanë njoftuar ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm”.

¹ Në rastet kur informacioni i kërkuar përmban të dhëna personale, kërkohet dokumenti i identifikimit të kërkuarit.

Në faqen zyrtare të AKEP www.akep.al, në linkun <https://akep.al/wp-content/uploads/2024/12/REGJISTRI-I-SIPERMARRESVE-TE-AUTORIZIMIT-TE-PERGJITHSHEM-DERI-NE-DATEN-17.12.2024.pdf>, gjendet i publikuar me të dhëna të përditësuara regjistri i sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike.

Forma dhe përmbajtja e këtij regjistri publik, bazohet në kuadrin ligjor dhe rregullator të sipërcituar.

Sipas këtij regjistri, sipërmarrësi Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a, me NIPT K42101801N, është regjistruar në “Regjistrin e Sipërmarrësve për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike”, sipas Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm dhe është pajisur me Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit Nr. AKEP-2020-AP-01051 datë 03.03.2020.

Ky sipërmarrës ka të drejtë të ofrojë:

- rrjete publike tokësore fikse;
- shërbime publike të komunikimeve elektronike ku përfshihen shërbim i aksesit në Internet dhe shërbimi Transmetim të dhënash;
- shërbimi i linjave me qira.

Sa më sipër ju sugjerojmë, t’i drejtoheni sipërmarrësit Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a, për të marrë përgjigje për pyetjet tuaja.

Të tjera të dhëna

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: ME SHKRESË ME SHKRIM

Vetëm për përdorim zyrtar

Data e marrjes: __/__/2020

Numri rendor i kërkesës:

Komente: _____

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al, [portalit pyetshtetin.al](http://portalit.pyetshtetin.al) apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik.
- ❖ Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Ju mund të dërgoni një kërkesë edhe nëpërmjet portalit pyetshtetin.al
- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.